

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Ranillugut z. Gradimir Mikić**

I nderuari z. Mikić,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ndërtimin e rrugës Ranillug, Glogovc, Dreminjë e Epërme dhe e Poshtme deri në fund të mandatit (do të mbeten vetëm 1.100 km të pandërtuara);
- Ndërtimin e kanalizimit në fshatin Domoroc;
- Përkujdesje për ambientin: pastrimin e ujërave të zeza në lumin Moravë si dhe pastrimin e fshatrave nga mbeturinat;
- Themelimin e kompanisë komunale për menaxhimin e mbeturinave, e cila do të ketë kamionin për mbledhjen e mbeturinave, furnizim me konteniera, formimin e deponisë së komunës, me ç'rast do të ulet edhe pagesa për kontenier;
- Ngritjen e vetëdijes tek qytetarët për mirëmbajtjen e ambientit;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN)